

## Procesverbal

*Nga Mbledhja VI (e gjashtë) e rregullt e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më datë:  
27.06.2025*

### *Rend Dite*

- 1) Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
- 2) Shqyrtimi i materialit të Kuvendit për Seancën VI të rregullt;
- 3) Eventuale.

**Miralem Rahte:** ë nderuar anëtarë të Komitetit për Komunitete, përfaqësues të OSBE-së, të gjithë të ftuarit e pranishëm, hap mbledhjen e 6-të të Komitetit për Komunitete për këtë vit. Para se të fillojmë me mbledhjen, dëshiroj të konstatoj nëse kemi kuorum. Meqë e kemi, dëshiroj të shtroj pyetjen nëse të gjithë anëtarët e Komitetit për Komunitete e kanë pranuar materialin në kohën e përcaktuar ligjërisht dhe të përkthyer në gjuhët tuaja amtare?

A ka ndonjë që kërkon fjalën në lidhje me rendin e ditës?

E vë në votim miratimin e rendit të ditës së propozuar për sot.

Kush është **për** – kundër – abstenim –

Meqë rendi i ditës u miratua, kalojmë te pika e parë e rendit të ditës.

#### **Pika I – Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara**

Z. Miralem Rahte – A ka ndonjë që kërkon fjalën në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës dhe procesverbalet?

Meqë nuk ka, e vë në votim miratimin e kësaj pike të rendit të ditës.

Kush është **për** – kundër – abstenim –

Konstatoj se kjo pikë e rendit të ditës miratohet.

#### **Pika II – Shqyrtimi i materialeve të Kuvendit për seancën e 6-të**

A dëshiron dikush të marrë fjalën lidhur me pikën e parë të rendit të ditës?

1. A ka ndonjë që kërkon fjalën lidhur me këtë pikë, Propozim-Vendimi për miratimin e KAB-it?

**Nedžmidin Sejdilar:** Apo dush shqip me të thënë, në qoftë se nuk më kuptojsh qysh duhet? Okej! I ndertum z.Fetahu, unë sot kam qenë prezent edhe në Komitet për Politikë dhe Financa. Aty u hap një debat i ashpër lidhur me buxhetin, me KAB-in. Unë mundësi s'kam pas me bo pyetje në atë Komitet, sepse ma kanë mohu të drejtën kushtetuese edhe ligjore me e bo atë pyetje. E kam lyp fjalën, po s'ma dhanë. Ajo është një çështje ku do ta adresojë te ndonjë institucion tjetër, po nuk është në pyetje me ju. Mua po më intereson – kryetari vetë tha – buxheti për komunitetet destinohet sipas vullnetit të komuniteteve. Prandaj, ne e dimë që në Kuvendin Komunal janë tri parti të komuniteteve prezent: është partia JGP, është partia VAKAT edhe unë prej Lëvizjes për Gorën. Po më intereson, a keni ju informatë, me kënd keni biseduar lidhur me hartimin e KAB-it për vitin 2026-2028? Faleminderit shumë!

**Uzair Hamza:** ë nderuar dhe përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Jam i detyruar si Shef i Zyrës, meqë bëhet fjalë për draft-buxhetin për vitin 2026 dhe 2027, të jap disa informata për anëtarët e Komitetit për Komunitete, pasi që këtë e kërkon Rregullorja për punën e Zyrave nr. 2/2010 dhe përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësisive. Pra, me vite të tëra ka qenë praktikë – më

mirë të them jo vetëm praktikë por edhe obligim administrativ – që shefat e zyrave të japin propozime për komunitetet jo-shumicë dhe të mbikëqyrin projektet që realizohen në fshatrat e komuniteteve jo-shumicë, sipas Rregullores 2/2010 për punën e Zyrës Komunale. Unë, si Shef i Zyrës, gjatë përgatitjes së buxhetit për komunitetet jo-shumicë, kam ftuar kryetarin e komunës, nënkryetarin Fejsal, drejtorin e urbanizmit, drejtorin e shëndetësisë – pra gjithë pushtetin ekzekutiv. Dhe, në përputhje me autorizimet, dua t'ju njoftoj se ata janë njoftuar dhe buxheti është ndarë. Ajo që është me rëndësi për mua si shef zyre, është se përqindja e ndarjes së investimeve kapitale është bërë në përputhje me ligjin, respektivisht me përfaqësimin proporcional të komuniteteve jo-shumicë. Buxheti për vitin 2026 është 4 milionë euro. Ne kemi rënë dakord për disa shpenzime të përbashkëta: borxhi për ujësjellësin – 406 mijë euro; për ndërtimin e deponisë – 80 mijë euro; për ndërmarrjen publike AKP – 100 mijë euro; për renovimin e kulmeve të objekteve në Dragash – 60 mijë euro; për renovimin e infrastrukturës si investim i përbashkët – 60 mijë euro; për arsim – 23,900 euro; bashkëfinancim për kontrata për ndriçim publik. Pra, shpenzimet e përbashkëta janë gjithsej 890 mijë euro. Mbeten për t'u ndarë 3 milionë e 100 mijë euro. 40% e kësaj shume është 1 milion e 224 mijë euro. Mua, si shef i zyrës, më intereson që këto para të mbeten këtu, që 1 milion e 224 mijë euro të përdoren në fshatrat e komuniteteve jo-shumicë. Më pak më intereson se në cilin fshat saktësisht apo sa do të shkojë – këtë e bëjmë sipas kërkesave. Ju e dini mirë që përfaqësuesit e fshatrave dërgojnë kërkesa për nevojat infrastrukturore – disa dërgojnë në zyrë, disa drejtpërdrejt te drejtori i urbanizmit. Në bazë të këtyre kërkesave kemi bërë konsultime dhe kemi arritur në një propozim preliminar të buxhetit, i cili për fat të keq dallon nga ai që u është shpërndarë anëtarëve të Kuvendit në mbledhjen ku do të miratohet. Si dëshmi për këtë, po ju tregoj emailin që i kam dërguar kryetarit të komunës pas mbledhjes me pushtetin ekzekutiv. Dua të theksoj se është pushteti ekzekutiv, e jo ai legjislativ, ai që e propozon buxhetin. Sa i përket komuniteteve jo-shumicë, propozimet që kemi bërë ne për fshatrat ndryshojnë plotësisht nga ato që ju janë dhënë juve si material përcjellës për Kuvendin. Nuk mund të flas për gjithë materialin, por flas vetëm për propozimin e buxhetit dhe ndarjen e buxhetit për investime kapitale nëpër fshatra – ai dallon nga ajo që ju është dërguar. Pas kësaj, kam biseduar me zyrtarët dhe më është thënë se ka ndodhur një gabim teknik – një gabim gjatë shtypjes në Excel, ku kur shkruan, për shembull, Brod, shfaqen të dhënat e vitit të kaluar dhe shërbimi nuk ka vërejtur këtë. Dhe për këtë arsye janë bërë gabime të mëdha. Ky është një problem teknik, dhe sapo e kam parë materialin që ju është dërguar, kam reaguar menjëherë dhe kam kërkuar që dikush prej nesh – qoftë unë, qoftë ndonjë nga ndonjë drejtorat – të ulet me shefin e financave dhe projekt për projekt të korrigjojnë të gjitha parregullsitë, që të jetë në përputhje me atë që kemi propozuar ne. Kjo që ju është dërguar nuk është versioni përfundimtar. Kemi edhe 100 mijë euro shtesë që janë ndarë për rindërtimin e rrugës drejt Kukalanit. Kryetari i komunës më njoftoi dje se ka arritur të sigurojë mjete shtesë nga ministria për financimin e këtij projekti. Pra, për komunitetet jo-shumicë, pas kësaj, shtohen edhe 100 mijë euro – kështu që do të jenë gjithsej 1 milion e 326 mijë euro, që do të tejkalojnë përqindjen e paraparë për ndarjen e mjeteve për komunitetet jo-shumicë. Kjo është ajo që mund të them. Ky është një praktikë që për vite është ndjekur në komunë. Zyra nuk vendos, por propozon në bazë të kërkesave, dhe gjithmonë kujdeset që ndarja të jetë në përputhje me përfaqësimin proporcional, sipas rregullores. Nëse në një fshat jepet më shumë apo më pak, për këtë nuk vendosim ne.

**Nedžmidin Sejdlar:** Zotërinj përfaqësues, ju falënderoj edhe juve, zoti Hamza. Ju dëgjova me vëmendje dhe arrita në përfundimin se ju keni ftuar në takim dhe keni përgatitur draftin e këtij buxheti me drejtorin e urbanizmit, Adijasan Behanin, drejtorin e shëndetësisë, Beharin, drejtorin

e shëndetësisë Behar Brenolin, keni ftuar zotin Miralem Rahte, keni ftuar Fejsalin, dhe keni ftuar Erxhen Limançe, i cili nuk ka ardhur. Duke e parë logjikisht dhe duke e njohur situatën në terren, kjo më duket si “unë ty Vojvodë, ti mua Serdar”. S’ka nevojë t’ju shpjegoj në detaje se çfarë nënkuptoj – nuk është as aq me rëndësi – por ekskluzivisht për hir të procesverbalit, sepse ndoshta për 400 vjet dikush do ta lexojë këtë që po bëjmë këtu, dhe të mos krijojë përshtypje të gabuar për mënyrën si janë ndarë dhe orientuar mjetet financiare. Thjesht, zoti Hamza, ju keni ftuar rrethin tuaj të ngushtë dhe jeni marrë vesh mes vete se si do ta orientoni paranë e qytetarëve të komunës së Dragashit nga rajoni i Gores. Kështu e kuptoj unë, dhe me shumë gjasë edhe qytetarët e komunës sonë. Një gjë tjetër shumë e rëndësishme që thatë, zoti Hamza, është se ne nuk kemi një draft të saktë të buxhetit në materialin që na është dërguar, por një material me gabime. Sipas mendimit tim, kjo është një punë shumë joserioze, sidomos për një shërbim që i jep delegatëve – përfaqësuesve të popullit – një material të gabuar. Unë, si përfaqësues i popullit, nuk mund t’i toleroj gabimet në Excel, sepse kjo është një institucion serioz dhe organi më i rëndësishëm i komunës. Kuvendi është organi numër një dhe këtu gabimet në Excel nuk janë të tolerueshme – edhe pse, duhet ta pranojmë, ndodhin shpesh, dhe gjithnjë e më shpesh. Në raporte gjithmonë ka ndonjë gabim, kur diçka nuk shkon mirë, gjithmonë thuhet “është gabim në Excel”. Këtë e ka dëshmuar edhe praktika. Megjithatë, duke marrë parasysh që tani nuk kemi material adekuat, ne nga komunitetet jo-shumicë nuk kemi kushte që të shqyrtojmë draft-buxhetin në seancën e së hënës. Sepse kemi material të gabuar. Imagjinoni t’i jepni një nxënësi në shkollë apo studentit në fakultet një tekst shkollor me informacione të pasakta. Si do ta kalojë ai provimin? Në lidhje me këtë, zoti kryesues, pres mirëkuptimin tuaj dhe mirëkuptimin e kolegëve të tjerë në këtë sallë. Propozoj që pika për shqyrtimin e këtij buxheti të shtyhet për ndonjë nga seancat e ardhshme, sepse nuk kemi material të saktë dhe nuk e dimë për çfarë të diskutojmë. Edhe vetë zoti Hamza e tha këtu që materiali është i paplotë, dhe më herët, në Komitetin për Politikë dhe Financa, edhe kryetari i komunës përmendi që ka gabime në Excel. Zoti Hamza tregoi edhe emailin që ia kishte dërguar kryetarit ku theksonte se ka gabime. Ju keni dërguar material me gabime, dhe unë jam përgatitur mbi bazën e atij materiali. Tani, kërkoj që Komiteti për Komunitete të japë propozim Kuvendit që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për ndonjë nga seancat e ardhshme, sepse asnjë delegat me ndërgjegje nga Gora nuk mund të diskutojë dhe të votojë për këtë pikë të rendit të ditës nëse deri më sot kemi pasur informacione të pasakta.

**Samidin Xheladini:** Ju përsëritet të gjithëve! Ne këtu jemi për me dhënë kontribut. Në qoftë se ka gabime, duhet t’i përmirësojmë edhe t’i adresojmë çështjet ku duhet. U kuptue, në rregull është, e morëm vesh, e ngritet një çështje që unë nuk e kam ditë. Tash e ndjeva edhe unë, edhe ne të gjithë. Mua nuk më erdh mirë, derisa e ngrite një çështje shumë me rëndësi, kur po thuesh edhe po insistojsh që të mos debatohet. Ti po biesh në kundërshtim me atë që ti po mendojsh, po e lansojsh këtu. Pse? Se derisa na jemi në përgatitje për buxhetin final që bëhet në shtator, të gjitha gabimet, të gjitha propozimet që janë me vend, të gjitha çështjet duhet me i debatue na. Edhe në Kuvend për atë është: me u debatue. Edhe e dyta, ne si Kuvend i kemi detyrat e ndara. Detyrat e ekzekutivit janë tjera, të legjislativit janë tjera. Ty atje që s’ta kanë dhënë të drejtën e fjalës, kanë pas të drejtë. Në KPF. Po këtu e ke të drejtën e fjalës, edhe e ke të drejtën e fjalës në Kuvend. Ti e ke vendin në Kuvend. Ekzekutivi punën e vet po e bën. Ti edhe unë e bëjmë punën këtu te vendi ynë. Ky nuk është buxhet final, ky është propozim. Krejt në rregull je ti, po në qoftë se ti e hekish mendimin se nuk duhet të debatohet. Mendim jem është që pikërisht duhet të debatohet. PSe? Se është e vërtetë që ti ke gjet gabime. E, mos na mbaj për shkretas këtu!

**Nedzmidin Sejdlar:** I nderum z.Xheladini, nuk e di a e kuptoni. Nëse mund ta kryej fjalën, sepse ju dëgjova me vëmendje. Çështja për mu është shumë serioze. Unë të hënën duhet me

debatu për KAB-in, në Kuvend. Unë materialin e kam pranë në formën elektronike, me të njëjtën kohë, të njëjtën datë, bashkë me ju. Dallimi është: materiali juaj për pjesën e Opojës, krejt të dhënat janë të sakta. Materiali për të cilin unë brengosem, për pjesën e Gorës, janë krejt të pasakta. Prandaj, unë dhjetë ditë jam përgatit me ato të dhëna të pasakta. Z.Xheladini, ju lutem, më dëgjoni! Unë po du me bashkëpunu. Unë me e pas qëllimin tjetër, nuk foli në gjuhën tënde, për me m'kuptu ti ma mirë. Unë kam telashe, dhjetë ditë e kam pas materialin e gabuar, me të dhëna të pasakta. Ju në pjesën e Opojës i keni të dhënat e sakta. Unë po ju kuptoj juve plotësisht, sepse ju i keni të dhënat e sakta, e ne i kemi të pasakta. E, unë qysh të debatoj të hënën në seancë, kur jam përgatit me të dhëna të **Uzair Hamza**: Që të mos ketë paqartësi, e përsëris edhe një herë: sa i përket mjeteve financiare, gjithçka është në rregull. Pra, ekzistojnë gabime vetëm në emërtimin e projekteve. Do të thotë, si komunitet nuk jemi dëmtuar, nuk na janë zvogëluar mjetet, nuk kemi marrë më pak mjete – thjesht bëhet fjalë për gabime teknike. Dhe nuk është vetëm “p.sh.” – por është ky dokument që dëshmon se kjo është e vërteta.

**Miralem Rahte**: Përshëndetje për të gjithë. Meqë kemi parë se ekziston një gabim i qartë në materialin që na është dërguar, unë, në konsultim me shefin e zyrës, Hamzën, propozoj që secili delegat dhe si komitet për komunitete të marrim materialin e korigjuar, pra që kjo pikë të rikthehet me ndryshimet e nevojshme, për t'i rregulluar ato gabime teknike. Ky është propozimi im. Faleminderit.

**Munir Jonuzi**: Unë mendoj se ai takim është mbajtur në cilësinë e përfaqësuesit të fshatit Rapçë. Ne kemi debatuar më së shumti – për të mos thënë vetëm – për projektet në Rapçë. Prandaj, duke qenë se jam në këshillin e fshatit në emër të Rapçës, besoj se ftesa ka qenë për këtë arsye dhe jo si nënkryetar i Kuvendit. Po të kishim biseduar si nënkryetarë të Kuvendit me shefin e zyrës, atëherë do të kishim folur edhe për projektet në fshatra të tjera.

Dhe të ndërlihem me këto gabime: më vjen mirë që ky është buxheti i vërtetë, propozimi i saktë i buxhetit, dhe jo ai që na është dërguar në material. Sepse, ajo që na është dërguar në material ishte vërtet katastrofale. Ju keni dy propozime, ndaj vendosni vetë si do të veproni. Unë, si nënkryetar i Kuvendit, çfarëdo që të vendosni nesër në Kuvend, do ta respektoj. Faleminderit.

**Samidin Xheladini**: Me folë kërkush nuk ia ka ndalë kërkujt. Por, duhet me na respektue edhe neve, sikur na qysh po ju respektojmë juve. Kërkush nuk ta ka mohue! Më së shumti që ke fole, ti je. Kërkush nuk ta ka ndalë fjalën, as në Kuvend e as kërkund. Ke folë pa ligj, pa të drejtë, shumë sende ke folë që nuk të takojnë hiç si delegat, edhe ne nuk kemi bo zë. Në kë mbajt peng, në të shumtën e rasteve na ke mbajt peng këtu, duke bërë akuza pa lidhje, fjalë të rrugëve. Ke thënë gjëra që nuk kanë të bëjnë me realitetin hiç, edhe janë dëshmue që nuk janë të vërteta. Edhe na nuk kemi bo zo hiç, kemi hesht, të kemi respektue. Ti e ke obligim, me gjithë mu bashkë, problemet, të padrejtat edhe dobësitë krejt me i eliminue edhe me i qit ato të vërtetat, ato që duhet këtu. Edhe këtu, edhe në Kuvend. Tash e biesh argumentin që u bo gabim, edhe në rregull. Në anën tjetër, e kundërshtojsh me u bo debat. E, çka është atëherë? Hyp se të vrava, zhdryp se të vrava! Qekjo mua më pengoi, se ke shumë në rregull edhe më erdh mirë. E dyta, sa i përket buxhetit, dihet qysh shkohet. Nuk shkohet ti e unë qysh të dona, buxheti dihet qysh propozohet. Ne kemi të drejtë vetëm me diskutue edhe me debatue, edhe në fund ne, bashkërisht me vendos a duhet me u bo kështu apo ashtu. E, jo me diktat ti. Kjo është shumë e rëndë. Mu s'më pengon – në daç votoni, në daç mos, është e drejtë e juaja – por kjo është shumë e rëndë. E, këto gjëra ti i ke bo gabim. Për atë unë të kundërshtova, se asgjë nuk kam kundër – e dish ti shumë mirë që kam raporte shumë të mira me ty. Unë kam me ty, e ti me mu çka ke, është punë e jotja. Vetëm dije një send: Mos bën akuza, se më godasish edhe mu, edhe na godasish edhe tjerëve. Se ti mendojsh se hajt se po e gjuaj dikënd edhe s'ma ndien. Ti gjuan, por dije që i stërpikish edhe të tjerët. Se nuk guxojsh

ti me gjujt të pavërteta, e unë me rrit në heshtje. E pavërteta në qoftë se del në opinion edhe unë nuk reagoj, ajo ka me dalë se qenka qashtu. Qaty është problemi. Ti kur të gjujsh, gjuj me argument, sikur që pate argument, edhe ke të drejtë, edhe ne të përkrahim për atë komplet. Edhe shumica, edhe pakica. Edhe gabime bëhen. Në qoftë se ai ka bo – se nuk e di kush është – ai nuk është as i zgjedhur i popullit, ai e ka bo një gabim, le të vjen edhe përgjegjësi le të japë, s’është problem. Pse akuzon njerëz të tjerë pa faj? A është mirë pa faj me akuzue? Në qoftë se unë e kam bo një gabim, edhe juve me ju akuzue krejtve, me ju shti me një thes sikur mu që e kam bo gabimin, a? A është fer kjo? Këtu është problemi. Dalloje shapin edhe sheqerin! S’po due me hi, se nuk e di kush është ai person, por mund të ndodhë gabimi. Edhe shumë mirë u bo që u mor vesh. E zgjidhim problemin, na bjer materialin, e shohim. Na e debatojmë, a e votojmë, a s’e votojmë, është çështje krejt tjetër. Në qoftë se e shohim të arsyeshme, nuk e votojmë, ama me e debatue me u hek, nuk bën! Përkundrazi, bile duhet me u debatue deri në fund edhe me u zgjidh ky problem, se për atë punë jemi këtu. Faleminderit!

**Nedžmidin Sejđilar:** A ka argument më të madh se fakti që një person i cili ka marrë pjesë në përgatitjen e buxhetit del në foltore dhe thotë se ka gabime teknike dhe se buxheti për pjesën gorane, sa i përket investimeve kapitale, është i pasaktë? Unë po ju them: materialin e kam pranuar para dhjetë ditësh. Në bazë të atyre të dhënave jam përgatitur për seancën e së hënës. E tani më jepni të dhëna të tjera. Unë kam fundjavën të planifikuar dhe nuk kam kohë të merrem me këtë. Nëse kam një arsye racionale për të kërkuar që kjo pikë të shtyhet për ndonjë nga seancat e ardhshme, që të marr materialin e saktë, të përgatitem mbi bazën e tij dhe pastaj të diskutojmë për të – atëherë kërkesa ime është legjitime. E sa i përket asaj që ndodhi në Komitetin për Politikë dhe Financa – unë do ta zgjidh përmes institucioneve tjera. Përse nuk kam të drejtë të flas në Komitetin për Politikë dhe Financa? Ligji ma lejon – neni 39.54 i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. Faleminderit!

**Miralem Rahte:** E vë në votim propozimin e Nedžmidinit për të hequr këtë pikë nga rendi i ditës i Kuvendit. Kush është **për – kundër – abstenim** – Konstatoj se propozimi **nuk është miratuar**. Jepet propozimi im që anëtarëve t’u shpërndahet materiali **pa gabime. Miratohet.**

- Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës – **Miratimi i listës rezervë**. Kush është **për – kundër – abstenim** – **Miratohet.**

---

### **Pika e tretë e rendit të ditës**

**Miralem Rahte:** A ka diskutues për këtë pikë të rendit të ditës? A kemi ndonjë kërkesë të drejtuar Komitetit? A dëshiron ndonjë nga të pranishmit të marrë fjalën dhe të hapë ndonjë diskutim?

Meqenëse nuk ka, me këtë **mbyllet seanca e sotme e Komitetit për Komunitete.**

**Kryesuesi i Komitetit për Komunitete  
Miralem Rahte**

